



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.122/2016

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Nisma për Kosovë dega në Gllogoc (Drenas), paraqitur kundër Lirije Cakiqit, për shkak të votimit në emër të motrës së saj gjatë ditës së votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit (Drenasit) të datës 18.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 21.12.2016, mori këtë:

#### VENDIM

Konstatohet se ankesa Anr.122/2016 e datës 19.12.2016 e subjektit politik Nisma për Kosovë dega në Gllogoc (Drenas), **konsiderohet se është tërhequr**

#### Arsyetim

Me datën 19.12.2016 subjekti politik Nisma për Kosovë dega në Drenas ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se në fshatin Tërstenik në vendvotimin 030 votuesja Lirije Cakiqi, ka ardhur për të votuar me letërnjoftim të motrës së saj Arjana Cakiqi e cila edhe ka nënshkruar në emër të saj. Këtë dukuri sipas parashtruesit të ankesës e ka vërejtur vëzhguesi i subjektit politik Nisma për Kosovë dhe i cili e ka paraqitur rastin duke e evidentuar në librin e votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17 pika 2 e Rregullës 09/2013 si dhe nenin 89.2 të LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në shkresën me nr. protokollit 122/2 të datës 20.12.2016, kërkoi nga parashtruesi i ankesës për ta plotësuar ankesën Anr. 122/2016 të datës 19.12.2016 gjegjësisht që ta specifikoj saktësisht se në cilën qendër të votimit konkretisht në cilin vendvotim ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që vendvotimi 030 i theksuar në ankesë nuk ekziston si i tillë.

Përkundër kërkesës së bërë nga PZAP-i, parashtruesi i ankesës nuk ofroi përgjigjen e kërkuar lidhur me plotësimin e ankesës në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës konstaton se ankesa e tillë konsiderohet se **është tërhequr** për këto arsye:

PZAP-i konsideron se përkundër kërkesë së bërë ndaj parashtruesit të ankesës lidhur me plotësimin e ankesës ashtu siç edhe parashihet me dispozitat e nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, parashtruesi i ankesës nuk ka dorëzuar plotësimin e ankesës në fjalë për çka PZAP-i konsideron se në qoftë se ankesa e tillë nuk kthehet për përmisim dhe plotësim brenda afatit të përcaktuar nga PZAP-i, e njehta do të konsiderohet si e tërhequr.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 6 par.3 dhe nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.122/2016 më datën 21.12.2016.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.